



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 12, nenit 17, shkronja **b**, neni 40, shkronja **1** të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28, qershor 2008), nenit 10, paragrafi 2.5 të Ligjit nr. 04/L-174, për planifikim hapësinor, Udhëzimit administrativ MMPH, nr. 01/2018, për elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planeve rregulluese të hollësishme, nenit 15, paragrafi 15.1, shkronja **b**, nenit 33, paragrafi 33.2, shkronja **b** dhe neni 34, paragrafi 34.1, shkronja **d**, të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 05.02.2019, merr këtë

VENDIM

PËR FILLIMIN E HARTIMIT TË PLANIT RREGULLUES TË HOLLËSISHËM PËR ZONËN TE FAKULTETI TEKNIK, NË LAGJEN "BREGU I DIELLIT"

Neni 1

Lloji i dokumentit të planifikimit hapësinor

MIRATOHET Vendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm për zonën te Fakulteti Teknik, në lagjen "Bregu i Diellit".

Neni 2

Përkufizimi i dokumentit të planifikimit hapësinor

Planet rregulluese të hollësishme përcaktojnë kushtet për rregullimin e hapësirave për zona urbane apo zona rurale, siç është përcaktuar në Planin zhvillimor komunal dhe Hartën zonale komunale.

Neni 3

Qëllimi i hartimit

Me hartimin e Planit rregullues të hollësishëm nga neni 1 i këtij vendimi, planifikohet zhvillimi hapësinor në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimi i tyre me nevojat reale dhe mundësitë për të arritur kushte optimale të zhvillimit dhe organizimit hapësinor, rregullimit dhe ndërtimit të zonës për të cilën hartohet plani.

Neni 4

Kufiri i territorit

Në bazë të Planit rregullues të hollësishëm nga neni 1 i këtij vendimi, do të përpunohet hapësira e përfshirë në kuadër të Planit zhvillimor komunal të komunës së Prishtinës, dhe parcelat që bëjnë pjesë në këtë zonë shtrihen në kuadër të Zonës kadastrale Prishtinë, e cila ka një sipërfaqe prej $S=9.08$ Ha.

Neni 5

Subjekti përgjegjës për hartim

Bartës i hartimit të planit është Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm e Komunës së Prishtinës.

Neni 6

Mjetet dhe mekanizmat e nevojshëm për hartim

Mjetet për hartimin e dokumentit të planifikimit hapësinor janë të siguruar nga buxheti i Komunës së Prishtinës.

Neni 7

Afati i hartimit

Bartësi i hartimit të dokumentit të planifikimit hapësinor sipas nenit 1 të këtij vendimi, është i obliguar që dokumentin e planifikimit hapësinor ta hartojë në afat prej 6 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Neni 8

Konsultimet publike

Projektpropozimi i Planit rregullues të Hollësishëm para finalizimit duhet të vihet në konsultime publike dhe në shqyrtim publik. Paraqitja e propozim Planit rregullues të hollësishëm në shqyrtim publik dhe koha për dhënien e shqyrtimeve dhe komenteve do të shpallen përmes njoftimeve publike.

Neni 9

Afati i vlefshmërisë

Plani rregullues i hollësishëm mbulon një periudhë së paku tetë (8) vjeçare.

Stampa e Komitetit të Përbashkët të Qytetit të Prishtinës

Neni 10

Gjuha zyrtare

Plani rregullues i hollësishëm sipas nenit 1 të këtij vendimi, duhet të jetë në gjuhët zyrtare të Komunës dhe së paku në 3 (kopje) të shtypura e të vulosura dhe 3 kopje digjitale të originalit.

Neni 11

Programi

Pjesë e këtij vendimi është programi për hartimin dhe menaxhimin e procesit të planifikimit, i paraparë sipas nenit 11, pika 1.3 të Ligjit për planifikim hapësinor, nr. 04/L-174.

Neni 12

Hyrja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-350/01-0026729/19, më 06.02.2019

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

